



Date: 15.05.2026

A.nr.1974/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, si procesmbajtëse, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1974/2025, të datës 02.12.2025, të parashtruar nga ankuesja V.M-Sh, kundër organit të punësimit: Komunës së Obiliqit, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 si dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 15.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1974/2025, e datës 02.12.2025, e parashtruar nga ankuesja V. M- Sh.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi përfundimtar me numër protokolli Nr.12-111-01-36147-25 i datës 24.11.2025, i Njesisë së Burimeve Njerëzore për shpalljen e rezultateve përfundimtare lidhur me konkursin numër reference RN00018974, për pozitën e punës *Zyrtar Mbështetës-Projekt*, të shpallur nga Komuna e Obiliqit.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil, V.M-Sh, (në tekstin e mëtejme referuar: *Ankuesja*), më datë 02.12.2025, përmes postes elektronike: ankesa.kpmschck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit në intervistë më gojë në procedurën e pranimit më numër të referencës RN00018974, për pozitën e punës *Zyrtar Mbështetës-Projekt*, të shpallur nga Komuna e Obiliqit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Obiliqit, ndërsa, kjo e fundit, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me provat materiale referuar çështjes ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokoli 1974/2025 të datës 02.12.2025, e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 10.12.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 15.12.2025; ID e ankueses; Projekti dhe përshkrimi i detyrave nga DKRS me Nr. 14-104-02-34471-25 të datës 04.11.2025; Kërkesa me numër 14-104-02-34793-25 të datës 07.11.2025; Vendimi për Miratimin e Projektit me numër 02-110-03-34797-25 të datës 07.11.2025; Konkursin me numër RN00018974 për pozitën Zyrtar Mbështetës-Projekt; Listën e Aplikantëve; Listën e verifikimit paraprak me numër 12-111-01-35644-25 të 19.11.2025; Vendimin për themelimin e komisionit të rekrutimit, plotësim ndryshimin e vendimit dhe akte emërimet e anëtarëve të komisionit; Listën e pyetjeve të intervistës; Formularët e vlerësimit të intervistës për ankuesen; Aplikacionin e ankueses me dokumentet e bashkëngjitura; Listën përfundimtare të kandidatëve.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e pa bazuar, sepse:

Gjenda e fakteve

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se:

- Komuna e Obiliqit bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 37 paragrafi 2, 3 dhe 4 dhe nenit 8 të Rregullores (QRK) Nr.03/2024 për Themelimin e Marrëdhënies së Punës me Kontratë për Periudhë të Caktuar, më datë 07.11.2025, ka shpallë konkursin për praninë me numër reference RN00018974, për Grupin e administrimit të përgjithshëm, respektivisht për pozitën e punës “Zyrtar Mbështetës-Projekt”, një (1) vend të lirë pune, për realizimin e një projekti, në Sektorin Kulturë, Rini dhe Sport, kohëzgjatja e emërimit tre (3) vite, i hapur për aplikim nga data 08.11.2025 deri më 14.11.2025.
- Rrjedhimisht nga shkresat e lëndës, del se ankuesja ka aplikuar në këtë konkurs, më c’rast e njëjta është përfshirë në listën e verifikimit paraprak duke iu nënshtruar intervistës, mirëpo, që bazuar në Njoftimin për renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 24.11.2025, ankuesja nuk ka arritur pikët e mjaftueshme në intervistë për të qenë në listën fituese, respektivisht, ankuesja ka grumbulluar 52.33 pikë.
- Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit, më datë 24.11.2025, ka publikuar Njoftimin përfundimtar me numër protokoli Nr.12-111-01-36147-25 i datës 24.11.2025, nga i cili njoftim rezulton se asnjë kandidat nuk ka fituar shtatëdhjetë (70) pikë dhe se procedura nuk mund të vazhdojë tutje.

Pretendimet ankimore

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se gjatë intervistës është përgjigjur në mënyrë të plotë, profesionale dhe të argumentuar në të gjitha pyetjet, 10 prej tyre përveç njëres që ka qenë më pak e sigurt. Kërkon që Këshilli të bëjë rishqyrtimin e procesit të vlerësimit.

Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji lidhur me këtë çështje juridike-administrative, iu referua bazës ligjore në fuqi, gjegjësisht Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë 37 të këtij ligji ku përcaktohet se: *Neni 37 Marrëdhënia e punës në shërbimin civil 1. Marrëdhënia e punës sipas këtij kapitulli është marrëdhënie juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunëses/it civil që themelohet me aktin e emërimit, përveç në rastet kur parashikohet ndryshe me dispozitat e këtij ligji. 2. Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil është ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohet ndryshe vetëm në rastet kur parashihet shprehimisht në këtë ligj. 3. Përjashtimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, marrëdhënia e punës në shërbimin civil mund të themelohet me kontratë për një periudhë të caktuar në këto raste: 3.1. për realizimin e projektit të caktuar të institucionit përkatës.*

Për me tepër, Kolegji mori parasysh edhe Rregulloren (QRK) Nr.03/2024 për Themelimin e Marrëdhënies së Punës me Kontratë për Periudhë të Caktuar me theks të veçantë:

-Nenit 4 : *Marrëdhënia e punës në shërbimin civil mund të themelohet me kontratë për një periudhë të caktuar në këto raste: 3 / 12 1.1. për realizimin e projektit të caktuar të institucionit përkatës; 1.2. për plotësimin e një pozite në rast të mungesës së përkohshme. 2. Kontrata e punës për periudhë të caktuar lidhet për aq sa është e nevojshme, por jo më të gjatë se tre (3) vite për kontratën sipas nën paragrafit 1.1 të këtij neni dhe jo më të gjatë se dy (2) vite për kontratën sipas nën paragrafit 1.2. të këtij neni. 3. I punësuari me kontratë sipas këtij neni, nuk gëzon të drejtën për vazhdim të kontratës së përkohshme, që tejkalon afatin e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.*

-Neni 5: *Themelimi i marrëdhënies së punës për realizimin e projektit të caktuar 1. Marrëdhënia e punës në shërbimin civil mund të themelohet me kontratë për një periudhë të caktuar për realizimin e një projekti të caktuar. 2. Projekti sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të aprovohet nga titullari dhe të ketë mbulesë financiare në buxhet. 3. Përshkrimi i projektit sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të përmbajë të paktën kohëzgjatjen e projektit, koston e detajuar, numrin e punëtorëve që do të angazhohen, pagesën e tyre.*

-Nenit 7, *Kërkesa për themelimin e marrëdhënies së punës me kontratë për një periudhë të caktuar në rast të mungesës së përkohshme duhet të arsyetohet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i pozitës dhe të miratohet nga Zyrtari Kryesor Administrativ i institucionit. 2. Kërkesa për themelimin e marrëdhënies së punës me kontratë për projekt të caktuar aprovohet nga titullari i institucionit. 3. Procedurat e përzgjedhjes për pozitën me kontratë për një periudhë të caktuar zhvillohen nga NjMBNj e institucionit përkatës. 4. Themelimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil me kontratë për një periudhë të caktuar në rast të mungesës së përkohshme bëhet për kategorinë profesionale dhe të specialistit nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur, publike, në përputhje me parimet e përcaktuara në LZP. 5. Shpallja e procedurës së përzgjedhjes për pozitë bëhet nga NjMBNj në SIMBNj, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 6. Pranimi i aplikacioneve nga kandidatët për pranim në shërbimin civil bëhet sipas afatit të përcaktuar në shpallje, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se shtatë (7) ditë. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive*

profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimin paraprak e bën NjMBNj e institucionit që zhvillon procedurën e përzgjedhjes ndërsa vlerësimin profesional e bën Komisioni i Përzgjedhjes. 9. Në procedurën e verifikimit paraprak kandidatët nuk vlerësohen me pikë, ndërsa në vlerësimin profesional mund të vlerësohen deri në njëqind (100) pikë.

-Neni 12: Shpallja e rezultatit përfundimtar 1. Vlerësimi përfundimtar i intervistës dhe jetëshkrimit për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve e të gjithë anëtarëve. 2. Pas përfundimit të intervistës dhe vlerësimit të jetëshkrimit, Komisioni i Përzgjedhjes përgatit listën përfundimtare të cilën e përcjellë tek NjMBNj në të cilën shënohet emri dhe mbiemri i kandidatit si dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat. 3. Lista publikohet në SIMBNj, në ueb faqen e institucionit dhe mjete të tjera të përshtatshme për informim. 4. Kandidati që merr më së shumt pikë por jo më pak se pragu prej shtatëdhjetë (70) pikëve, konsiderohet kandidat fitues.

-Neni 13 1. Komisioni i Përzgjedhjes për vlerësimin profesional të kandidateve për përzgjedhje themelohet me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ të institucionit që zhvillon procedurën e përzgjedhjes. 2. Komisioni i Përzgjedhjes ka tre (3) anëtarë, në këtë përbërje: 2.1. dy (2) nëpunës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas pozitës për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) nëpunës profesional i specializuar në fushën përkatëse sipas pozitës për të cilin zhvillohet konkurrimi.

Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimet e ankueses për vlerësim jo te drejt në intervistën më gojë, thekson faktin së vlerësimi i përgjigjeve të dhëna nga kandidatët është vlerësim diskrecion i Komisionit Përzgjedhës, dhe për rrjedhojë ankuesja nuk ka mundur të argumentoj më asnjë provë pretendimet e saj se në këtë fazë të procedurës është bërë ndonjë shkelje në raport me vlerësimin e saj, kështu që, nga vlerësimi i përgjithshëm e njëjta nuk ka mund të arrij pikën e nevojshme për të qenë kandidate fituese apo së paku 70 pikë siç parashihet me nenin 12 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr. 03/2024 Për Themelimin e Marrëdhënies së Punës me Kontratë për Periudhë të Caktuar, ku përcaktohet: *Kandidati që merr më së shumt pikë por jo më pak se pragu prej shtatëdhjetë (70) pikëve, konsiderohet kandidat fitues..*

Rrjedhimisht, duke qenë së nuk janë evidentuar shkelje procedurale dhe materiale lidhur e procedurën e kontestuar, e meqenëse asnjëri nga kandidatët e përfshirë në vlerësimin profesional të intervistës, nuk ka arritur numrin e mjaftueshëm të pikëve për t'u konsideruar kandidat fitues, atëherë, më të drejtë Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Obiliqit ka përfunduar procedurën pa kandidatë fitues sipas Njoftimi me numër protokolli Nr.12-111-01-36147-25 i datës 24.11.2025.

Thënë si më lartë, e duke u bazuara në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si ne dispozitiv te këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë-Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.1974/2025

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, V. M- Sh;
- Kryetarit të Komunës se Obiliqit dhe Njesisë së Burimeve Njerëzore; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.